Bashkia Has

PLANI VENDOR I VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2025–2030

Përgatitur nga Bashkia Has

Korrik 2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA HAS

Miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr 67 Datë 29/08/2025

Tabela e Përmbajtjes

HYRJE 3

I MISIONI, VIZIONI, KUADRI LIGJOR DHE INSITUCIONAL 4

Vizioni 4

Misioni 4

Kuadri ligjor dhe Institucional 4

II. QËLLIMET STRATEGJIKE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKE 6

III Analiza e Situatës 7

IV ANALIZA E MJEDISIT TË JASHTËM DHE PIKAT E FORTA DHE DOBËTA BRENDA ORGANIZATËS 11

4.1 Analiza e burimeve njerëzore 11

4.2 Analiza PESTLE 11

4.3 Analiza SWOT 12

V PLANI VEPRIMIT 15

VI . RAPORTIMI DHE MONITORIMI 20

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA HAS

HYRJE

Bashkia Has përbëhet nga 4 njësi administrative: Krumë, Fajza, Gjinaj dhe Golaj. Bashkia kufizohet në veri dhe perëndim me Bashkinë Tropojë, në jug me Bashkinë Kukës dhe në lindje me Republikën e Kosovës. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Krumës. Sipas Censusit të vitit 2011, kjo bashki numëron 16,790 banorë, ndërsa sipas Regjistrit Civil ajo numëron një popullsi prej 21,716 banorë. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 29 fshatra. Bashkia e Hasit është një zonë kufitare, ku një pjesë e banorëve kalojnë kufirin rregullisht për punësim apo për arsimim në zonën e Gjakovës në Kosovë, ku gjenden edhe lidhjet historike kulturore dhe ekonomike të krahinës. Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 399.62 km2. Sipas censusit, densiteti i popullsisë është 42.01 banorë/km2 ndërsa sipas regjistrit civil densiteti është 53.16 banorë/km2. Relievi i zonës shtrihet nga rreth 300 metra mbi nivelin e detit deri në malet e larta të Gajrepit, Pashtrikut dhe Maja e Kunorës, të cilat gjenden në lartësitë 1400-1900 metra mbi nivelin e detit.Hasi gjendet gjithashtu në shtegun turistik malor Theth-Valbonë-Kukës dhe turizmi rural apo malor mund të jetë një perspektivë e mirë ekonomike për këtë zonë.
Nisur nga fakti se ekonomia në rrethin e Hasit varet kryesisht nga burimet nëntokësore të kromit, sfidë kryesore mbetet koordinimi dhe bashkëpunimi mes institucioneve të Bashkisë dhe kompanive që punojnë në këtë sektor. Rigjallërimi i shfrytëzimit të minierave do të sillte rritjen e punësimit dhe mirëmenaxhimin e të ardhurave që merren nga kjo industri.

Analiza demografike e Bashkisë Has vë në dukje rritjen e popullsisë në grupmoshën mbi 65 vjeç, duke sjellë sfida për infrastrukturën shoqërore dhe shëndetësore. Nevojat për kujdes shoqëror shtohen për këtë grupmoshë, ndërkohë një grup tjetër në moshën 50-64 vjeç përballon sfidat e punësimit dhe kërkon mbështetje nga programet sociale. Zvogëlimi i popullsisë së grupmoshës 15-24 vjeç lidhet me emigrimin, ndërsa ende nuk janë zhvilluar shërbime mbështetëse të mjaftueshme në nivel lokal (në nivel bashkie). Kapacitetet financiare të kufizuara dhe mungesa e shërbimeve të integruara sociale janë sfidat kryesore që duhet adresuar. Nevoja për një sistem të integruar të shërbimeve sociale përmban një qasje holistike që siguron përmirësimin e koordinimit dhe efikasitetit në përmbushjen e nevojave komunitare. Ky integrim mund të sjellë shërbime më të personalizuara dhe më të qëndrueshme për të mbështetur individët dhe familjet në nevojë. Analiza e fondeve të Bashkisë Has tregon se 42%[1] e buxhetit të saj shkon për shërbime sociale, i cili përballohet 95% financimi i qeverisë qendrore. Kjo situate tregon një nivel të lartë varësie të bashkisë nga financimi qendror për shërbimet sociale, pa mundësitë e saj për gjenerim të burimeve të veta dhe potencialisht duke kufizuar autonomine financiare në ofrimin e shërbimeve për komunitetin. Struktura aktuale e shërbimit shoqëror në bashki nuk është e aftë të plotësojë nevojat e grupeve në nevojë. Ka deficencë në personelin e stafit, mungojnë strukturat për të identifikuar grupet në nevojë dhe nevojat e tyre, menaxhimet e rasteve të dhunës dhe fëmijëve në rrezik. Riorganizimi i strukturës së shërbimit shoqëror në bashki është një domosdoshmëri që duhet adresuar menjëherë.
Barazia gjinore është një nga parimet themelore të shoqërisë demokratike dhe një kusht i domosdoshëm për zhvillimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik. Në nivel vendor, kjo nënkupton që gratë dhe burrat të kenë mundësi të barabarta për të kontribuar dhe përfituar nga zhvillimi i komunitetit. Bashkia Has, në përmbushje të përgjegjësive të saj si njësi e qeverisjes vendore, merr angazhimin për të ndërtuar një shoqëri më të drejtë, gjithëpërfshirëse dhe të barabartë për të gjithë qytetarët e saj, pa dallim gjinie.

Hartimi i Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2025–2030 përbën një hap konkret në këtë drejtim. Ky plan është ndërtuar në përputhje me Ligjin nr. 9970, datë 24.7.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri", me prioritetet e përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për

[1] Drejtoria e Finances Bashkia Has

Barazinë Gjinore 2021–2030, si dhe në përputhje me objektivat e Agjendës 2030 të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim të Qëndrueshëm. Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore (PVBGJ) 2025-2030, mbulon një tërësi fushash dhe në të parashikohen veprime që synojnë: respektimin e të drejtës themelore të barazisë ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve; trajtimin e çështjeve të pabarazive dhe diskriminimit; veprime për eliminimin e steriotipeve gjinore; pjesëmarrjen e balancuar të grave dhe burrave si dhe të të rejave e të rinjve në vendim-marrjen politike e publike; aksesin në shërbime të ndryshme të konceptuara sipas nevojave të veçanta të grave dhe burrave, të të rejave e të rinjve, apo vajzave dhe djemve, si dhe ofrimin e këtyre shërbimeve me cilësi e në respektim të parimeve të barazisë; integrimin e këndvështrimit gjinor në të gjitha planet dhe fushat për zhvillim të qëndrueshëm; planifikimin e mbështetur në burimet e duhura, etj.

Metodologjia e hartimit të këtij plani është ndërtuar duke marrë në konsideratë Bashkinë Has si një njësi e veçantë administrative me karakteristikat e saj gjeografike, demografike dhe sociale. Ajo është përqendruar në analizimin e nevojave konkrete për shërbime sociale të popullsisë, me fokus të veçantë tek grupet më të ndjeshme gjinore. Procesi ka përfshirë mbledhjen dhe analizimin e të dhënave sasiore, aty ku ishin të disponueshme, për secilin grup target dhe për shërbimet ekzistuese që ofrohen në territorin e bashkisë. Gjithashtu, janë identifikuar boshllëqet dhe potencialet për zhvillimin e mëtejshëm të shërbimeve në funksion të barazisë gjinore dhe përfshirjes sociale. Kjo qasje ka siguruar që plani të bazohet në evidenca dhe të jetë realist, i zbatueshëm dhe i përshtatur me kontekstin lokal.

I MISIONI, VIZIONI, KUADRI LIGJOR DHE INSITUCIONAL

Misioni

Të promovojë dhe zbatojë barazinë gjinore në të gjitha fushat e jetës vendore përmes politikave të ndjeshme gjinore, forcimit të pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje, përmirësimit të aksesit në shërbime sociale dhe ekonomike, si dhe fuqizimit të grupeve më të cenueshme, nëpërmjet një qasjeje të bazuar në të drejtat e njeriut, barazi dhe zhvillim të qëndrueshëm.

Vizioni

Bashkia Has synon të jetë një komunitet gjithëpërfshirës, ku gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë gëzojnë të drejta të barabarta, mundësi të barabarta dhe akses të barabartë në zhvillim, pjesëmarrje dhe shërbime publike, pa diskriminim dhe pabarazi gjinore

Kuadri ligjor dhe Institucional

Kur flasim për kuadrin ligjor dhe të politikave në fushën e barazisë gjinore, duhet të kemi parasysh që e drejta për barazi ndërmjet gjinive buron që në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë (neni 18), që është edhe dokumenti ligjor më i lartë në hierarkinë ligjore të vendit. Nën nenin 18 të kushtetutës qartësohet shprehimisht se: "*1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit; 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore; 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive.*". Kjo barazi de-jure është gjithashtu e shprehur edhe në një tërësi instrumentash ndërkombëtarë, të cilët kur

ratifikohen nga Parlamenti shqiptar, zënë vend në hierarkinë ligjore të vendit menjëherë pas Kushtetutës, çfarë nënkupton që nëse për një çështje të caktuar nuk ka një parashikim të qartë në legjislacionin vendas, atëherë për zgjidhjen e saj u drejtohemi parashikimeve në instrumentat ndërkombëtarë të ratifikuar.

a) Instrumente ndërkombëtarë

- Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe burrave në jetën vendore (EU Charter for Equality).
- Konventa për Eliminimin e të gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAË).
- Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit (BDPfA).
- Konventa e KE për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit).
- Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ).
- Strategjia e Barazisë Gjinore 2020-2025 e Bashkimit Evropian dhe Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore (GAP III) 2021-2025, etj.

b) Kuadri ligjor kombëtar

- Ligji Nr. 9970 datë 24.07.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri".
- Ligji Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".
- Ligji Nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore".
- Ligji Nr. 125/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar[2].
- Ligji Nr. 124/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.221/04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 35/2020 "Për një ndryshim në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 136/2015 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara".
- Ligji Nr.104/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 101/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor para universitar në Republikën e Shqipërisë".
- Ligji Nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë".
- Ligji Nr. 65/2016 "Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë".
- Ligji Nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës".
- Ligji Nr. 37/2017 "Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur".
- Ligji Nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti".

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA HAS

[2] Së bashku me Ligjin Nr. 47/2018 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar, si dhe me të gjithë ndryshimet e mëparshme që ka pësuar ligji bazë Nr. 9669/2006.

- Ligji Nr. 35/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 7905, datë 21.03.1995, "Kodi i Procedurës Penale", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 79/2017 "Për sportin".
- Ligji Nr. 22/2018 "Për strehimin social".
- Ligji Nr. 15/2019 "Për nxitjen e punësimit".
- Ligji Nr. 75/2019 "Për rininë", etj.

c) ***Politikat kombëtare***

Të gjitha masat dhe veprimet e parashikuara në këtë PVVBGJ 2023 – 2025 kuptohet që mbështeten edhe në strategjitë apo planet kombëtare të veprimit që mbulojnë sektorët (drejtoritë) e caktuara sipas fushave të tyre. Por politika kryesore kombëtare mbi të cilën bazohet ky PVVBGJ është Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 -2030[3].

II. QËLLIMET STRATEGJIKE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKE

Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore 2025-2030 përmban në themel të tij vizionin ***për një Has ku gratë dhe burrat, të rejat dhe të rinjtë, si dhe vajzat dhe djemtë, pavarësisht moshës, nevojave të veçanta, grupit etnik e social, përkatësisë fetare, orientimit seksual apo identitetit të tyre gjinor, trajtohen sipas parimit të barazisë dhe drejtësisë gjinore, në të gjitha fushat e jetës***.

Ai përbëhet nga qëllime strategjike dhe objektiva specifike të paraqitura në vijim:

Qëllimi strategjik:	1. Promovimi i të drejtës për barazi të grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, si dhe vajzave dhe djemve, si parakusht themelor për demokracinë dhe shoqërinë demokratike.
Objektivat specifike:	1.1. Të rritet pjesëmarrja e grave dhe të rejave në të gjitha takimet dhe dëgjesat publike të organizuara nga Bashkia Has. 1.2. Të fuqizohet mekanizmi institucional vendor për arritjen e barazisë gjinore.
Qëllimi strategjik:	2. Promovimi i parimit të barazisë ndërmjet grave dhe burrave, si dhe të rejave dhe të rinjve, në jetën politike e publike, përmes përmbushjes së angazhimeve publike për barazinë gjinore, të ndërmarra nga Bashkia Has.
Objektivat specifike:	2.1. Të rritet pjesëmarrja e grave dhe të rejave të zonave rurale, si dhe grave dhe të rejave me aftësi të kufizuara, në procesin e votimit për zgjedhjet vendore dhe qendrore 2.2. Të përmbushen angazhimet publike zyrtare ndaj parimit të barazisë së grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, si dhe vajzave dhe djemve në jetën publike, të ndërmarra nga Bashkia Has.
Qëllimi strategjik:	3. Reduktimi i steriotipeve dhe pabarazive gjinore, përmes promovimit të parimit të barazisë ndërmjet grave dhe burrave,

[3] Miratuar me VKM 400, datë 30.06.2021. Shiko: https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/07/Strategjia-Kombetare-per-Barazine-Gjinore-2021-2030.docx

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

	të rejave dhe të rinjve, si dhe vajzave dhe djemve, në aksesin dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara
Objektivat specifike:	3.1. Të reduktohen steriotipet gjinore në arsim 3.2. Të sigurohet një qasje e përshtatshme e grave dhe burrave, si dhe të rejave dhe të rinjve nga grupet në nevojë, ndaj informacioneve shëndetësore. 3.3. Të sigurohet një qasje e barabartë e grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, si dhe vajzave dhe djemve, në shërbimet dhe përkujdesin social si dhe në përfshirjen sociale të tyre. 3.4. Të promovohet askesi në informacion dhe qasja e barabartë në strehim, për grupe të veçanta. 3.5. Të promovohet e drejta e qasjes së barabartë të vajzave dhe djemve, si dhe të rejave e të rinjve në veprimtaritë dhe institucionet sportive, artistike dhe kulturore. 3.6. Të rritet efektiviteti i qasjes shumë-sektoriale dhe shërbimeve bazë të specializuara për viktimat/të mbjetuarit/at e dhunës me bazë gjinore dhe trafikimit.
Qëllimi strategjik:	4. Reflektimi i parimeve të planifikimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm, përmes integrimit të balancuar të përmasave ekonomike, shoqërore, urbanistike e mjedisore.
Objektivat specifike:	4.1. Të ndërmerren veprime të përshtatshme për çuarjen përpara të barazisë ndërmjet grave dhe burrave, si dhe të rejave e të rinjve në fushën e zhvillimit ekonomik dhe punësimit. 4.2. Të përfshihet perspektiva gjinore në procesin e planifikimit dhe zbatimit të projekteve e iniciativave në zhvillimin urban, transport e mjedis.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA HAS

III ANALIZA E SITUATËS

Numri i popullsisë në Bashkinë Has në vitin 2025 sipas Gjendjes Civile është 21,800 banorë, 50.45% e të cilëve janë gra dhe vajza. 18.5% e popullsisë së Bashkisë banojnë në qytet dhe 81.65% e popullsisë banojnë në fshatra. Gjatë viteve 2020-2025 popullsia është ulur me 95 banorë ose e thënë ndryshe, në vitin 2025 Bashkia Has regjistron 0.43% banorë më pak se viti 2020. Në këto 5 vitë, njësitë Krumë dhe Gjinaj paraqesin nivel mëtë lartë të uljes të popullsisë me respektiviasht 42 dhe 35 banorë më pak në vitin 2025, ndërsa 2 njësitë e tjera Fajza dhe Golaj kanë një ulje më të vogël, respektivisht 8-10 banorë. Dinamike paraqitet trendi i ndryshimit të popullsisë sipas grupmoshave, konkretisht rezulton: një rënie të popullsisë në grupmoshat 0-19 vjeç (3.75%) dhe 20-29 vjeç (4.87%), por një trend në rritje për grupmoshat 30-49 vjeç (1.35%), grupmoshat 50-59 vjeç kanë ulje (2.25%), ndërsa grupmoshat 60-69 vjeç dhe mbi 70 vjeç kanë një rritje prej 5.78% dhe 4.58% përkatësisht[4].

Rënia e numrit të të rinjve në grupmoshat 0-19 vjeç dhe 20-29 vjeç sugjeron një tendencë të shqetësuese për potencialin e rënies së gjeneratave të reja. Kjo rënie e të rinjve mund të interpretohet si një shenjë e emigracionit të tyre jashtë territorit apo largimit nga zona për shkaqe të ndryshme. Ulja e grupmoshave 50-59 vjeç tregon për një proces të plote të plakjes

[4] Tabela nr 1 dhe 2

së popullsisë. Ky grup është në një fazë kur njerëzit fillojnë të ndihen më pak të gatshëm për të bërë lëvizje ose të kërkojnë ndryshime të mëdha në jetën e tyre, ndaj edhe rënia e tyre është më e kuptueshme. Rritja e grupmoshave 60-69 vjeç dhe mbi 70 vjeç (5.78% dhe 4.58% përkatësisht) sugjeron një rritje në moshën e popullsisë, gjë që sjell nevojën për kujdes të shtuar shëndetësor dhe social. Profesionistët vendorë shprehen se faktorë si emigracioni, migrimi brenda vendit dhe numri i lindjeve janë përgjegjës për këto ndryshime të strukturës së popullsisë në Bashkinë Has.

Tabela 1 Të dhëna demografike

Njësitëadministrative	Popullsia e BashkisëHas viti 2020			Popullsia e BashkisëHas viti 2025		
	Total	M	F	Total	M	F
Njësia administrative Krumë	8,040	4130	3,910	7998	4,032	3,966
Njësia administrative Golaj	8,135	4179	3,956	8125	4,102	4,023
Njësia administrative Fajza	4,360	2240	2,120	4,352	2,197	2,155
Njësia administrative Gjinaj	1,360	699	661	1,325	669	656
Total	**21895**	**11247**	**10,648**	**21,800**	**11,000**	**10,800**

Tabela 2 Të dhëna demografike sipas grupmoshës

Grup-mosha	Popullsia sipas grupmoshave 2020					Popullsia sipas grupmoshave 2025				
	NJA Krumë	NJA Golaj	NJA Fajza	NJA Gjinaj	**Total**	NJA Krumë	NJA Golaj	NJA Fajza	NJA Gjinaj	**Total**
0-4	404	408	219	68	**1,099**	382	388	208	63	**1,042**
5-9	458	464	249	78	**1,248**	444	451	242	74	**1,211**
10-14	459	465	249	78	**1,250**	457	464	249	76	**1,246**
15-19	532	539	289	90	**1,449**	498	506	271	83	**1,358**
20-24	604	611	327	102	**1,644**	568	577	309	94	**1,549**
25-29	663	671	360	112	**1,806**	636	646	346	105	**1,733**
30-34	597	604	324	101	**1,625**	608	618	331	101	**1,657**
35-39	508	514	276	86	**1,384**	524	533	285	87	**1,429**
40-44	457	462	248	77	**1,244**	462	470	252	77	**1,260**

45-49	477	482	259	81	**1,298**	470	477	256	78	**1,280**
50-54	531	538	288	90	**1,447**	515	523	280	85	**1,403**
55-59	561	568	304	95	**1,528**	552	561	300	91	**1,505**
60-64	545	552	296	92	**1,484**	565	574	307	94	**1,540**
65-69	434	439	235	73	**1,182**	470	477	255	78	**1,280**
70-74	326	329	177	55	**887**	342	348	186	57	**933**
75-79	240	242	130	41	**652**	242	246	132	40	**660**
80-84	170	172	92	29	**464**	183	185	99	30	**498**
85+	75	76	41	13	**204**	80	81	43	13	**217**
Total	**8,040**	**8,135**	**4,360**	**1,360**	**21,897**	**7,998**	**8,125**	**4,352**	**1,325**	**21,800**

Mekanizmi i Referimit të rasteve të dhunës në familje vepron në nivel vendor konform Protokollit të Menaxhimit të Rasteve në bazë të Ligjit nr. 9669 datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" i ndryshuar dhe VKM 334/2011 "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij".

Gjatë viteve 2020-2025 janë trajtuar rreth 20 raste të dhunës në familje, paraqitur në tabelën më poshtë.

Numri më i lartë i rasteve të dhunës rezulton në NJA Fajzë.Sipas të dhënave për periudhën 2020-2023, nga NJA Gjinaj nuk ka asnjë raportim për dhunë në familje.

Bazuar legjislacionit shqiptar rastet e pajisura me Urdhër të Menjëhershëm Mbrojtje (UMM), dhe/ose Urdhër Mbrojtje (UM) përfitojnë NE prej 9900 lekësh. Në fakt të gjitha rastet me UMM/UM (në vite) në 4 Njësitë Administrative nuk rezulton të kenë përfituar pagesë/NE. Specialisti që mbulon çështjet e dhunës e shpjegon këtë situatë me faktin se viktimat:i)nuk kanë informacion mbi ndihmën; ii) nuk janë të interesuara për pagesën; iii) ose janë larguar në bashki të tjera ose jashtë shtetit.

Sipas diskutimeve me profesionistë në Bashkinë Has në zonat rurale të Bashkisë ka dhunë në familje, por ajo mbetet e paraportuar për shkak të mentalitetit, mungesës së informacionit, ndërgjegjësimit të ulët, nivelit të ulët ekonomike dhe varësisë ekonomike, mungesës së besimit tek institucionet.

Në Bashkinë Has, është ndërtuar sistemi elektronik i regjistrimit dhe i ruajtjes së të dhënave për rastet e dhunës në familje pranë njësisë vendore.



Tabela 3. Rastet e dhunës në familje 2020-2025

Njësitë administrative	Raste të dhunës me UM						Raste të dhunës me UM përfitojnë pagesë					
	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Krumë	0	4	2	2	2	1	0	0	0	2	2	1
Golaj	1	2	1	1	3	1	0	0	0	1	3	1
Fajza		2		3	1	1	0	0	0	3	1	1
Gjinaj							0	0	0			
Total	**1**	**8**	**3**	**6**	**6**	**3**	**0**	**0**	**0**	6	6	3
	Total 2020-2025:					**27**	**Total 2020-2025 :**					**15**

Për vitin 2025 (deri në Korrik), evidentohen 3 raste te dhunës në familje, sipas të dhënave vetëm pas viti 2023 është bërë e mundur që rastet e dhunës me UM të përfitojnë pagesën sipas ligjit.

Në Bashkinë Has mungojnë shërbime shoqërore në mbështetje të viktimave të dhunës. Mungesa e shërbimeve shoqërore për viktimat e dhunës dhe mungesa e burimeve financiare të Bashkisë për ngritjen e qendrës për menaxhimin e rasteve të dhunës, mungesa e organizatave të shoqërisë civile që ofrojnë shërbime të specializuara në territor për rasteve e dhunës ka bërë që deri në Korrik 2025 rastet e dhunës në bashki të menaxhohen nga stafi i Bashkisë të ndihmuar me familjarë të viktimave të dhunës. Në disa raste bashkia është mbështetur nga OJF që operojnë në Kukës. Ajo që vlen të përmendet është fakti se numri i rasteve të dhunës që trajtohen nga organizatat ka qenë relativisht shumë i ulët, kryesisht vetëm për rastet e rënda.

Megjithëse zhvillimet e mësipërme dhe angazhimet e pushtetit lokal në mbrojtje të viktimave të dhunës, megjithëse janë organizuar fushata të ndryshme informimi dhe ndërgjegjësimi për dhunën në familje, denoncimin e saj, dhe përfitimet e NE, sfidat për Bashkinë Has për mbështetjen e viktimave të dhunës janë:

1. Planifikimi i fondeve lokale për plotësimin e nevojave për menaxhimin e rasteve të dhunës;
2. Rritja e kapaciteteve të stafit të Bashkisë për evidentimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës;
3. Zgjerimi i MKR me kryepleqtë e fshatrave;
4. Vijimi i fushatave ndërgjegjësuese për komunitetin, kryesisht në zonat rurale.

Shërbimet shoqërore të ofruara në vite në Bashkinë Has kanë qenë sporadike, jo të konsoliduara dhe me kapacitete të limituara. Për shërbimet e mëparshme nuk janë realizuar vlerësime apo auditime. Në përfundim të projekteve, për shkak të mungesës së financimit, shërbimet janë mbyllur.

Në bashkinë Has gjatë vitit 2024 në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është arritur që të krijohet dhe të funksionojë qendra lëvizëse për PAK e cla ofron shërbimet e logopedisë dhe fizioterapsë.

IV ANALIZA E MJEDISIT TË JASHTËM DHE PIKAT E FORTA DHE DOBËTA BRENDA ORGANIZATËS

4.1 Analiza e burimeve njerëzore

Struktura organizative e Bashkisë Has përfshin Sektorin e Ndihmës Ekonomike dhe Përkujdesjes Shoqërore si një ndër sektorët kyç për ofrimin e shërbimeve sociale dhe zbatimin e politikave sociale me ndikim në barazinë gjinore. Ky sektor funksionon në varësi të një përgjegjësi sektori dhe përbëhet nga nëntë specialistë që mbulojnë programe si ndihma ekonomike, pagesat për personat me aftësi të kufizuara dhe mbështetja për kategori të tjera në nevojë, konkretisht në Krumë një specialist për personat me AK dy specialista për NE, Golaj dhe Fajza një specialist për NE dhe një specialist pëe PAK dhe në njesinë Gjinaj një specialist që kryen të dyja funksionet edhe NE dhe Pak. Gjithashtu në strukture ka një specialist për familje dhe fëmijë dhe kordinat të identifikimit dhe rëferimit të nevojavePavarësisht përpjekjeve institucionale, një nga mangësitë më të theksuara është mungesa e Njësisë së Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave (NJVNR), e cila sipas legjislacionit duhet të funksionojë në nivel vendor si një mekanizëm ndërsektorial për identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e rasteve në nevojë. Kjo njësi ende nuk është ngritur në mënyrë formale dhe funksionale, gjë që pengon krijimin e një sistemi të integruar dhe efektiv për adresimin e çështjeve të ndërlidhura me barazinë gjinore. Në të njëjtën kohë, mungesa e një databaze të mirëfilltë dhe të përditësuar mbi individët dhe familjet në vështirësi – përfshirë informacionin gjinor, statusin ekonomik dhe nevojat për shërbime – përbën një pengesë në mbledhjen, analizimin dhe përdorimin e të dhënave për planifikim strategjik dhe ndërhyrje të synuara.

Këto boshllëqe në burimet njerëzore, mungesa e njësive të strukturuara për vlerësimin e rasteve, si dhe kapacitetet e kufizuara profesionale për trajtimin e problematikave me natyrë gjinore, kanë ndikuar drejtpërdrejt në procesin e hartimit të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore. Mungesa e sistemeve për menaxhimin e informacionit dhe pamundësia për të ndarë të dhëna të strukturuara midis njësive të ndryshme administrative ka vështirësuar hartimin e një analize të plotë të situatës gjinore në nivel lokal. Për të përmbushur në mënyrë të suksesshme objektivat e këtij plani, është e nevojshme që Bashkia Has të forcojë kapacitetet e saj njerëzore dhe institucionale përmes trajnimeve të specializuara, riorganizimit të strukturave ekzistuese dhe ngritjes së mekanizmave funksionalë të koordinimit dhe monitorimit të çështjeve gjinore.

4.2 Analiza PESTLE [5]

Faktorët politikë, ekonomikë, socialë, teknikë, ligjorë dhe mjedisorë që mund të ndikojnë në zhvillimin e ardhshëm të Bashkisë Has janë si më poshtë:

[5] PESTLE është një akronim për faktorët politikë, ekonomike, socialë, teknikë, ligjorë dhe mjedisorë që mund të ndikojnë në zhvillimin e ardhshëm të bashkisë.

Faktori politik: Bashkia Has përdor legjislacionin vendas për të ndërtuar programe mbështetëse për grupet e vulnerable. Bashkëpunimi me organizatat jofitimprurëse, institucionet publike dhe sektorin privat lejon krijimin e partneriteteve të ndryshme, rritjen e efikasitetit dhe përmbushjen e nevojave të komunitetit.
Faktorët ekonomikë: Bashkia punon në mënyrë të ngushtë me aktorët lokalë për menaxhimin efikas të burimeve financiare. Përkundër ngadalësimit të rritjes ekonomike dhe nivelit të lartë të papunësisë, bashkia po bën përpjeke për të siguruar shërbime sociale cilësore për të përmbushur nevojat e komunitetit.
Faktorët socialë: Bashkia Has reflekton një realitet me sfida sociale të rëndësishme, ku rritja e popullsisë mbi 65 vjeç dhe ulja e popullsisë 0-18 vjeç, së bashku me numrin e rritur të familjeve në nevojë dhe individëve me aftësi të kufizuara, paraqesin një kontekst me nevoja të thella. Së bashku me këtë, trendi i zvogëlimit të të rinjve që vazhdojnë arsimin e mesëm dhe oferta e kufizuar për punësim dhe formim profesional, reflektojnë nevojën për përmirësim në këto fusha. Në anën tjetër, trashëgimia kulturore e pasur e Bashkisë Has ofron potencial për zhvillim kulturor dhe turistik, ndërsa shërbimet sociale po ideoen t'u përgjigjur drejtpërdrejt nevojave të komunitetit. Megjithatë, përdorimi i kufizuar i teknologjisë tek grupmoshat e reja shfaq nevojën për një përdorim më të gjerë dhe më efikas të teknologjisë për të përmbushur më mirë nevojat sociale.
Faktorët teknikë: Regjistrat Elektronik Kombëtarë për NE, personat me aftësi të kufizuar dhe shërbimet sociale kanë përmirësuar aksesin dhe bashkëpunimin mes institucioneve. Administrata e bashkisë, e aftë në përdorimin e këtyre regjistrave ka ndihmuar për lehtësimin e procesit të aksesit të individëve në nevojë për shërbime sociale.
Faktori ligjorë: Bashkia Has ndërton veprimtarinë e saj në përputhje me ligjin, duke siguruar që ofrimi i shërbimeve sociale të përputhet me standardet dhe rregulloret vendore dhe kombëtare.
Faktorët mjedisorë: Pozita gjeografike dhe potenciali natyror i bashkisë (bimët mjekësore, turizmi) janë elemente pozitive që mund të ndikojnë në rritjen e shërbimeve sociale. Megjithatë, sfidat si emigrimi, plakja e popullsisë dhe mungesa e shoqërisë civile kërkojnë strategji të veçanta për të adresuar nevojat sociale në këto kushte.

Në përgjithësi, ndryshimet dhe përpjekjet që po bëhen në nivel lokal për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve sociale tregojnë për një angazhim pozitiv dhe një vizion për rritjen e cilësisë së jetës së komunitetit në Bashkinë Has. Bashkia po përdor plane dhe programe për të maksimizuar përparësitë dhe rritur cilësinë e shërbimeve sociale duke marrë parasysh faktorët mjedisore dhe kushtet e rrethit.



4.3 Analiza SWOT

Pikat e forta

Nevoja emergjente për shërbime sociale të ndjeshme ndaj dimensionit gjinor ka nxitur ndërgjegjësimin dhe vullnetin institucional për të ndërmarrë veprime konkrete në drejtim të barazisë gjinore në Bashkinë Has. Kjo është reflektuar në angazhimin e strukturave vendore për të përmirësuar ofertën e shërbimeve, duke vendosur në fokus edhe kategoritë e margjinalizuara gjinore si gratë kryefamiljare, viktimat e dhunës në familje dhe vajzat në

situatë rreziku Gjithashtu, Bashkia Has disponon kapacitete njerëzore dhe teknike të përshtatshme për të menaxhuar dhe zhvilluar shërbime sociale, përfshirë rolet e reja të krijuara në strukturë për familjen, fëmijën dhe koordinimin e rasteve në nevojë, duke treguar potencial për rritje dhe përshtatje me qasjen gjinore. Përvoja e mëparshme në projekte sociale dhe përpjekjet për të tërhequr fonde përmes bashkëpunimeve me institucione dhe donatorë e bën Bashkinë Has të gatshme për të zhvilluar më tej politika të ndjeshme gjinore dhe për të institucionalizuar shërbimet në këtë fushë.

Pikat e dobëta

Një nga sfidat kryesore në drejtim të barazisë gjinore mbetet mungesa e informacionit të strukturuar dhe të disagreguar sipas gjinisë për grupet vulnerabël, e cila e kufizon aftësinë e Bashkisë për të planifikuar dhe ofruar shërbime të përshtatura. Po ashtu, mungesa e një fondi të dedikuar për nevojat e grave dhe vajzave në rrezik, apo për mbështetjen e viktimave të dhunës në familje, kufizon ndërhyrjet efektive dhe të qëndrueshme. Mbështetja e kufizuar financiare për zbatimin e politikave gjinore dhe mungesa e një praktike të buxhetimit të ndjeshëm gjinor përbëjnë një boshllëk të rëndësishëm. Po ashtu, Bashkia Has përballet me mungesë partneritetesh të qëndrueshme me organizata që kanë përvojë në fushën e barazisë gjinore dhe mbrojtjes së të drejtave të grave, ndërsa prania e ulët e organizatave të shoqërisë civile e kufizon ofrimin e shërbimeve joformale dhe mbështetëse. Mungesa e ekspertizës vendore në fushën e planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të politikave për barazi gjinore dhe për mbrojtjen nga dhuna përbën gjithashtu një kufizim për zbatimin me sukses të këtij plani.

Mundësitë

Proceset reformuese në nivel kombëtar, përfshirë decentralizimin e shërbimeve sociale dhe përmirësimin e kuadrit ligjor dhe strategjik për barazinë gjinore, ofrojnë një terren të favorshëm për Bashkinë Has që të ndërtojë një qasje gjithëpërfshirëse ndaj politikave me ndjeshmëri gjinore. Mbështetja e vazhdueshme nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe mundësitë për financim nga fondet e qeverisë qëndrore apo donatorë ndërkombëtarë, hapin rrugë për zbatimin e masave konkrete në mbështetje të grave dhe vajzave. Gjithashtu, mundësia për bashkëpunim me sektorin privat dhe përfshirja e bizneseve lokale në mbështetje të shërbimeve sociale e fuqizon dimensionin komunitar të barazisë gjinore. Mbështetja në trajnime për stafin dhe ngritja e kapaciteteve institucionale janë një tjetër mundësi reale për të integruar perspektivën gjinore në mënyrë të qëndrueshme në politikat dhe programet vendore.

Kërcënimet (Rreziqet)

Migrimi i lartë dhe ndryshimet demografike të paparashikuara në komunitet mund të ndikojnë në strukturën e familjes dhe të rrisin kërkesat për shërbime sociale me fokus gjinor, të cilat aktualisht janë të kufizuara. Mungesa e koordinimit ndërsektorial mes njësive brenda Bashkisë dhe mes institucioneve të tjera vendore mund të ndikojë në efektivitetin e ndërhyrjeve për barazi gjinore dhe të pengojë krijimin e një mekanizmi funksional të referimit. Mungesa e interesit dhe përfshirjes së organizatave të shoqërisë civile në fushën gjinore e kufizon

zhvillimin e programeve inovative dhe mbështetëse për gratë dhe vajzat në nevojë, duke rritur varësinë nga burimet publike. Po ashtu, mungesa e traditës në ndërtimin e partneriteteve për barazi gjinore dhe mungesa e përvojës në administrimin e fondeve për këtë qëllim mund të përbëjnë një pengesë për zbatimin efektiv të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjino



V PLANI VEPRIMIT

MATRICA E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE

Objektiva		Indikatori	Afati i zbatimit		Burimi i financimit	Institucionet përgjeg	
			Afati i fillimit	Afati i mbarimit		Drejtoria/sektori/departamenti (udhëheqës)	Kost
Promovimi i të drejtës për barazi të grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, si dhe vajzave dhe djemve, si	1.1 Të rritet pjesëmarrja e grave dhe të rejave në të gjitha takimet dhe dëgjesat publike të organizuara nga Bashkia/Donatore Has.	- % e pjesëmarrjes së grave në takime publike	2026	2030	Bashkia/Donatore	Sektori i NE	900,(

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

parakusht themelor për demokracinë dhe shoqërinë demokratike. Promovimi i parimit të barazisë ndërmjet grave dhe burrave, si dhe të rejave dhe të rinjve, në jetën politike e publike, përmes përmbushjes së angazhimeve publike për barazinë gjinore, të ndërmarra nga Bashkia Has. Reduktimi i steriotipeve dhe pabarazive gjinore, përmes promovimit të parimit të barazisë ndërmjet grave dhe burrave, të	1.2 Të fuqizohet mekanizmi institucional vendor për arritjen e barazisë gjinore.	Nr. i grave të ftuara dhe të regjistruara në dëgjesa Nr. i trajnimeve mbi barazinë gjinore	2026	2030		Sektori i NE	1,20 lekë
	2.1 Të rritet pjesëmarrja e grave dhe të rejave të zonave rurale dhe me aftësi të kufizuara në zgjedhje.	- % e pjesëmarrjes në votime nga gratë në zonat rurale - Nr. i materialeve ndërgjegjësuese të shpërndara	2026	2030		Sektori i NE	900,(
	2.2 Të përmbushen angazhimet publike zyrtare për barazi gjinore.	- Nr. i deklaratave dhe angazhimeve publike - Raporte vjetore mbi barazinë gjinore	2026	2030	Bashkia/Donatore	Sektori i NE	900. 500. 500.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

rejave dhe të rinjve, si dhe vajzave dhe djemve, në aksesin dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara	3.1 Të reduktohen stereotipet gjinore në arsim.	- Nr. i aktiviteteve në shkolla mbi barazinë gjinore - % e nxënësve të informuar					
	3.2 Të sigurohet qasje në informacion shëndetësor për gratë dhe të rinjtë.	Nr. i fushatave të realizuara % e grave të informuara për shërbimet	2026	2030	Bashkia/Donatore	Sektori i NE	1,00(lekë
	3.3 Të sigurohet qasje e barabartë në përkujdesje sociale.	- % e grave që përfitojnë nga shërbimet sociale	2026	2030	Bashkia/Donatore	Sektori i NE	900,(
	3.4 Të promovohet qasja në strehim për gratë në nevojë.	- Nr. i përfituesve nga programet e strehimit - Nr. i rasteve të trajtuara me prioritet	2026	2030		i) Sektori i NE ii) Drejtoria e strehimit/ DRSHSSH	1,20(lekë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

	3.5 Të promovohet qasja në sport, art dhe kulturë për vajzat dhe djemtë.	Nr. i aktiviteteve sportive/kulturore gjithëpërfshirëse % e pjesëmarrjes së vajzave	2026	2030	Bashkia/Donatore/	Sektori i NE	1,40 lekë
	3.6 Të rritet efektiviteti i shërbimeve për viktimat e dhunës dhe trafikimit.	Nr. i viktimave që marrin ndihmë Funksionimi i mekanizmit të referimit	2026	2030	Bashkia/Donatore	Sektori i NE/ DRSHSSH	1,2
Reflektimi i parimeve të planifikimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm, përmes integrimit të balancuar të përmasave ekonomike, shoqërore, urbanistike e mjedisore.	4.1 Të ndërmerren veprime për barazi në zhvillim ekonomik dhe punësim.	Nr. i grave të punësuara përmes programeve vendore % e përfshirjes në kurse profesionale	2026	2030		Sektori i NE/ DRSHSSH	900,(

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

	4.2 Të përfshihet perspektiva gjinore në planifikimin urban dhe mjedisor. Zbatimi i Planit të Aktiviteteve vjetore	- Nr. i planeve me analizë gjinore - % e projekteve që reflektojnë nevojat gjinore	2026	2030	Bashkia/Donatore	Sektori i NE/ DRSHSSH	500

Kostot e parashikuara në këtë dokument janë indikative dhe të përgjithshme. Përllogaritja e detajuar e kostove sipas aktivitetit, vitit të zbatimit dhe burimeve të financimit do të kryhet në një fazë të mëvonshme, në bashkëpunim me drejtoritë përkatëse dhe në përputhje me mundësitë buxhetore të Bashkisë Has dhe partnerëve të tjerë të përfshirë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

VI . RAPORTIMI DHE MONITORIMI

Procesi i raportimit për aktivitetet e zbatuara do të kryhet nga drejtoritë përgjegjëse për zbatimin e këtyre aktiviteteve tek ***Komisioni Planifikues dhe Vendim-marrës për Barazinë Gjinore***, i cili do të ngrihet me Urdhër të Kryetarit pikërisht për këtë qëllim (në nivel Bashkie).

Menjëherë pas miratimit të Planit, si hap i parë i zbatimit të tij, çdo drejtori përgjegjëse do të hartojë fletët e treguesve me informacionin që duhet të mblidhet dhe raportohet në bazë aktiviteti, por edhe në bazë të objektivave specifike. ***Raportimet mbi akivitetet*** do të jenë ***periodike (çdo 3 muaj)*** ose në bazë të kërkesës së ***Komisionit Planifikues dhe Vendim-marrës për Barazinë Gjinore*** apo Kabinetit të Kryetarit. **Raportimet në bazë të objektivave specifikë** do të përgatiten ***dy herë në vit (çdo 6 muaj)***.

Monitorimi i zbatimit të Planit të Veprimit ***<u>në nivel të objektivave</u>*** do të kryhet nga një ***Komision në nivel të Këshillit Bashkiak***, të cilit do t'i atashohen edhe përgjegjësitë për çështjet e barazisë gjinore.

Bazuar në monitorimin e kryer, Plani do të ***rishikohet dhe përmirësohet*** **në fillim të çdo viti pasardhës.**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA HAS